

FTESE

INSTAT në bashkëpunim me: Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Universiteti European i Tiranës, Banka e Shqipërisë dhe Universiteti “Marin Barleti” do të organizojë një konferencë të gjerë me temë:

Shqipëria në fokusin e statistikave

Krahasime studimore dhe vlerësime

Qëllimi i kësaj konference është që të mundësojë një analizë dhe pasqyrim të thelluar dhe të gjerë të zhvillimeve ekonomike e sociale në Shqipëri me bazën e të dhënave të krijuar ndër vite nga INSTAT. Konferenca synon të forcojë edhe një vëzhgim krahasimor mbi zhvillimet makro-ekonomike me vendet e rajonit, veçantitë, sfidat dhe oportunitetet e përbashkëta.

Temat mbi të cilat do të përqendrohet konferenca janë:

1. Rritja ekonomike ndër vite dhe tiparet e saj: Faktorët e rritjes
2. Analiza sektoriale: Zhvillimet në sektorët kyç të ekonomisë. Arritje sfida dhe politika
3. Analiza e ndërmarrjeve: si po modelohet ndërmarrja shqiptare në kushtet e mundësive dhe sfidave të tregut të hapur. Strategjitë e biznesit me fokus në ndërmarrje në sektorët kyç të ekonomisë si dhe në ato të eksportit. A po forcohet aftësia konkurruese e ndërmarrjeve shqiptare.

INSTAT pret abstrakte deri në fund të marsit. Pas kësaj një komision i përzgjedhur nga të gjithë organizatorët do të përzgjedhë abstraktet më të mira. Kërkuesve do ti vihen në dispozicion bazat e të dhënave të INSTAT të grumbulluara gjatë viteve.

Kontakt:

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Blvd “Zhan d’Ark”, Nr.3, Tirana, ALBANIA
Tel: +355 (4) 222 24 11 / 223 33 56 / 223 33 57
Fax: +355(4) 228300
Mob: +355692028053
Email: axhikneli@instat.gov.al
altinxh@yahoo.com

